REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E NOVOBËRDËS - OPŠTINA NOVO BRDO
DALËSE - IZLAZNA
Nr/Br 01 / 253
Më/Dana: 19.03.2025
NOVOBËRDË - NOVO BRDO

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova - Republic of Kosova
**Komuna e Novobërdës**
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

**KUVENDI KOMUNAL-SKUPŠTINA OPŠTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY**

**Anëtarit të Kuvendit Komunal**
Z/znj_________________________________

**Në bazë të dispozitave te nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të dispozitave të nenit 41 të Statutit të Komunës së Novobërdës.**

**F T O J**

Mbledhjen e Tretë të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet më **27.03.2025** (E enjete) duke filluar ne ora **10:00.**

**R e n d i i d i t ë s**

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Aprovimi i Raporti Financiar Tetor-Dhjetor per vitin 2024;
3. Raportimi i Drejtoris së Inspeksionit rrethë aktiviteteve të punës në teren për vitin 2024.
4. Aprovimi i Kerkeses së Policis për dhenje në Shfrydzim të parceles 554-3 për ndertimin e Stacionit të policis.
5. Aprovimi i kerkeses së Kryetarit për dhënjen në shfrydzim të prones komunale në perjudhen afatgjate.
6. Të ndryshme;

Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.

**Më:19.03.2025**
**Në: Novobërdë**

**Kryesuese e Kuvendit**
**Milica Jovanovic**
___________________

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E NOVOBËRDËS - OPŠTINA NOVO BRDO
DALËSE - IZLAZNA
Nr/Br 01/252
Më/Dana: 19.03.2025
NOVOBËRDË - NOVO BRDO

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosova
**Komuna e Novobërdës**
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

**ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPŠTINE**

**PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e dytë e vitit 2025 e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë.28.02.2025, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Kuvendit znj.Mirjana Simijonovic, antarët e Kuvendit: Stojan Stanojevic, Dragana Dimic, Pranvera Kastrati Gashi, Negovan Jovanovic,Selatin Nuhiu, Dobrivoje Djordjevic, Vlora Vllasaliu, Violeta Milosevic, Milica Jovanovic, Kryetari i Komunes zt.Sasa Milosevic zv.Kryetari Zt.Bajrush Ymeri ,Zyrtarja per sherbime Publike zonj.Shefkije mehmeti , Zyrtari per Arsim Flamur Uka,Drejtori i Financave zt.Mlosh Denic.Menaxheri i Prekurimit zt.Fatos Ahmeti etj.

Kryesuesja e Kuvendit pasi pershendeti të pranishmit tha: konstatoj kemi korumin për të filluar punë ,prezent janë 14 antarë nga 15 gjithësej, kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojm mbledhjen me këtë:

Kryesusja Mirjana Simijanovic,para se të fillomë me rendin e dites dua të ju njoftoj se unë nga ky moment japë dorheqje të pa revokushme nga posti i Kryesuesit të Kuvendit për arsye të mija personale dhe nga ky moment ftoj zv.Kryesuesin që ta vazhdoj mbledhjen sipas rendit të dites.

Anëtari Stojan Stanojevic unë mendoj se ne duhet të votojm që ta miratojm dorheqjen tende.

Kryesusje Mirjana Simijonovic jo nese unë japë dorheqje ju se keni nevojn me votu.

Stojan Stanimirovic,po jo ti nuk mundesh qashtu veq po jap dorheqje se ne si antar të kuvendit të kemi votuar per kryesuese dhe ne duhet të votojm per tamiratuar dorheqjen.

Kryesusja po mirë pasi po insistoni që po e qesë në votim.

Kushë është Pro pranimit timë që të miratohet dorheqja ime nga posti i Kryesusit të Kuvendit,konstatoj se nga 14 anëtarë prezent 12vota pro dhe 1 apstenim ,dhe 1 anëtar nuk voton e këtë miratohet dorheqja,

Ju faleminderit, ftoj zv kryesuesin që ta udhëheq dhe ta vazhdoj mbledhjen.

Ramush Mehmeti i nderuar Kryetar i komunes,zv kryetar i komunes ju anëtarte kuvendit me qënë se kryesusja dha dorheqje dhe u miratua nga ana e juaj unë po e udhëheqi mbledhjen sipas rsndit të dites

**Rend dite**

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Aprovimi Raporti Financiar per vitin 2024;
3. Aprovim i raporti i zyres së prekurimin mbi ralizimin e planit të punes së prekurimit;
4. Informat nga drejtoria e arsimit per perfundimin e gjysem vjetorit të parë.2024/2025
5. Të ndryshme.

A ka dikushëqë don me shti ndonje pikë shtes apo po vazhdojm nese ka dikush urdheroni

Procesverbali i Kuvendit

Peanvera Kastrati Gashi ,i nderuar zv.kryesues sa i perket dorheqjes së kryesues nuk ke nevoja të jep dorheqje.ndersa sa i perket rendit dites kuvendi ka miratuar një vendim per komisionin per siguri në bashksi ku ata vinë në tekime por nuk paguhen,andaj po kerkoj qe kjo qeshtje te vendoset në rend dite dhe të diskutohet pse ky komision nuk ka marr pagesen.
Ramush Mehmeti këtë nuk mund ta fusim si pikë se për këtë qeshtje mund te diskutojm në piken në te ndryshme .
Ramush Mehmeti aka propozime tjera për piken shtes?
Ramush Mehmeti unë mendoj se pasi kryesusja dha dorheqje dhe dorheqja ju miratua,unë mendoj që ta fusim në rend dite zgjedhjen e Kryesuesit të kuvendit,
Po e qes në votim kush është pro keti propozimi qe ta fusim në rendin e dites.konstatoj se me 14 vota pro asnje kunder dhe asnje apstenim futet në rend te dites:Zgjedhja e Kryesuesit të kuvendit.
Atëhere po e qes në votim këtë Rendin e dites.

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Aprovimi Raporti Financiar per vitin 2024;
3. Aprovim i raporti i zyres së prekurimin mbi ralizimin e planit të punes së prekurimit;
4. Informat nga drejtoria e arsimit per perfundimin e gjysem vjetorit të parë.2024/2025
5. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit .
6. Të ndryshme

kush është pro keti rendi të dites:Konstatoj se nga 14anëtar prezent 14 votuan pro.

Zv.Kryesuesi atëhere fillojm me piken e parë të rendit të dites.

**Pika e parë:** Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
A ka dikush të shtoj rrethë procesverbalit nga mbledhja e kaluar,nese jo atëhere po e qes në votim kushështë pro procesverbalit nga mbledhja e kaluar,konstatoj se nga 14 anëtar prezent 14 votuan pro.

Kalojmë në piken e dytë te rendit të dites.

**Pika e dytë:** Aprovimi Raporti Financiar per vitin 2024;
Fjalen ja japë drejtorit të financave zt.Milos Denic urdheroni Drejtor.
Drejtori i Financave Milos Denic ju faleminderit zvkryesus,ju pershendes të gjithve pra siq tha edhe kryesusja materjalin per ketë pikë te rendit të dites e keni marrur me kohë,unë po ju njoftoj në pika te trasha rrethë raportit financiar per vitin 2024.
Në tabelen nr.14 buxheti final i komunes ka qenë 4 miljon e 333 mi euro,janë ralizuar 4 miljon e 329mi euro më tutje në raporti mund shihni ralizimin e buxhetit nëpër kadegori ekonomike ,në kodin per paga dhe meditje janë ralizu 2 miljon e 798 mi euro,670mi euro per mallra dhe sherbime,110 mi sherbime komunale ,414 mi janë subvencione,308 mi janë shpenzime kapitale,me tutje do të vazhdoj me te hyrat e komunes ku 189 mi euro janë të hyra komunale nga tatimet në komunë,330 mi janë te hyra jo tatimore,kemi edhe gjobat prej policis dhe rojeve të pyllit të cilat janë 98 mi euro.
Tani kemi nevojat e komunes ku janë 1 miljon e 19 mi euro të shpenzuara per nevoja komunale ku prej tyre 1 miljon i kemi nga të hyrat e tatimit,do të vazhdojm me obligimet qe kemi pasur nga viti 2024 në 2025 të bartuara r janë njeqind e 33 mi euro pjesa me e madhe janë ne mallra dhe sherbime obligimet kontigjente janë obligime tjera e ato janë obligime qe i kemi në gjykatë ku i kemi edhe 116 landë qe na kanë paditur e vlera e tyre është 270 mi euro.ndersa pasuria e komunes nën vleren 1000 euro është 72 mi euro ,
Për te hyrat komunale shkurtimisht nga viti 2023 janë 321 mi euro dhe kemi arritur të kemi të hyra mbi 95 mi euro keshtu që nga viti i kaluar të hyra komunale i kemi pasur mbi 900mi euro nga ato i kemi

shpenzuar 650 mi euro keshtu që na mbetet i bartim per ketë vitë edhe 217 mi euro dhe per fund nje informat shumë shkurt
Vitin e kaluari kemi bartur 33 mi euro nga viti parapral po ashtu aqë edhe i kemi fituar nga subvencionet.
Ju faleminderit per mirë kuptim nese ka ndonje pytje .
Zv.Kryesuesi ju faleminderit Drejtor,a ka dikush që don me diskutu nese jo po e hedhë në votim Raportin Vjetor Financiar per vitin 2024.
Kush është pro konstatoj se nga 14 anëtar prezent të 14 votojnë pro .
Kalojm te pika e tretë e rendit te dites.

**Pika e Tretë:** Aprovim i raporti i zyres së prekurimin mbi ralizimin e planit të punes së prekurimit;

Fatos Ahmeti ju faleminderit zv.Kryesues,ju pershendes të gjithë te pranishmit.
Realishtë zyra e prekurimit raportonë kryetarit të komunes dhe raporti i zyres së prekurimit shkon me raportin e kryetarit të komunes.
Është knaqsi e imja të ju raportij edhe juve me knaqsie kamë marr ftrsen me raportu para jushë,
Zyra e prekurimit gjatvitit fiskal 2024 ka ralizu 32 aktivitete të prekurimit vlera e ketyne aktiviteteve që kanë shkuar nepermes prekurimit është dikund, 879 mi ,nga keto 32 aktivitete të prekurimit vlera e kontratave të në nshkruara të ketyre aktiviteteve është 897 mi, nga keto 32 aktivitetev 12 aktivitete të prekurimit kanë qen me vlera të mdha mbi 10 mi euro,6 aktivitete janë në vlerë nënë 10mi euro, dhe 14 janë me vleren nënë 1000euro,dhe aktivitete që nuk janë planifikuar janë 3 aktivitete që janë financuar nga qeverija ku vlera e tyre ka qenë 682 mi euro,gjithashtu ju njoftoj se planifikimit të prekurimit që kemi pasur per vitin 2024 kanë mbetur dy projekte qe nuk janë ralizuar e ato janë Ndertimi i kanalizimit dhe renovimi i kulmit të shtepis se kultures në koretisht dhe stanishor,kjo mos ralizim ka ndodhur se ermbarusi i ka terhekë keto mjete financiare për shkak padijave per kontraten kolektive të arsimit.
Me materjal e keni marr raportin detaj që është raport qe i raportojm edhe KRPP-së,dhe aty janë te detajume vlerat e kontratave operatoret ekonomik është formular standart qe raportohet.
Ju njoftoj se mbi 90% e planifikimit të prekurimit është ralizu,ju faleminderit per durimin nese keni ndonje pytje jam i gatshem me ju pergjegjë.
Zvkryesusi ju faleminderit per diskutimin zt.Fatos a ka ndokush ndonje pytje nese jo kalojm në piken e rredhes.

**Pika e Katert:** Informat nga drejtoria e arsimit per perfundimin e gjysem vjetorit të parë.2024/2025

Zv Kryesusi për ketë pikë kemi zyrtarin e arsimit zt.Flamur Uka,urdhero zt.Flamur .

Flamur Uka,ju faleminderit zvkryesues ju pershendes juve prezent qka jeni në ketë sall

Kamë nderin të ju raportoj per fillimin e gjysem vjetorit të dytë arsimor jë raport të detajuar ju kamë derguar me shkrim dhe besoj se e keni marrur po unë po i ceki disa pika kryesore që kemi punuar para fillim gjysem vjetorit të dytë arsimor.
Perfundimi i gjysem vjetorit të parë ka qen në rregull në bazë te afateve të kalendarit arsimor po ashtu edhe fillimi i gjysem vjetorit të dytë ka filluar me kohë dhe gjithqka në rregull,i kemi pasur kontartae e lidhura me heret per ngrohje per transport të nxensave,materjale higjenike gjithqka ka vazhduar mirë librat janë siguruar me kohë kjo perjudhë është vetem perjudh vazhduse në te cilen nuk kemi probleme,koj eshtë e gjitha nuk deshta me lexu raportin ne detaj ju faleminderit.
Zv.Kryesuesi ju faleminderit Flamur nese ka dikush po e hapi diskutimin e nese jo kalojmë në piken e rredhes ,

**Pika e pest:** Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit.
Zv.kryesuesi para se të fillojmë me zgjedhjen e Kryesuesit të kuvendit ne do ta zgjedhim një komision prej 3 antarve si komision verifikues,andaj nga ju kerkoj të jepni propozimet.
Dobrivoje djordjevic ju faleminderit unë propozoj si anëtar te komisionit Stefan kovacevic.
Stojan Stanojevic unë propozoj Violeta Miloshevic ,Ramush mehmeti unë propozoj qe nga komuniteti Shqiptar të jetë Selatin Nuhiu.

Atëhere po e qes në votim ketë komision prej tre anëtarve si komisioni verifikues dhe numrues të votave.

1.Stefan Kovacevic Kryetar i komisionit
2. Violeta Miloshevic Anëtare
3. Selatin Nuhiu Anëtar.

Zv.Kryesuesi kush është pro qe ky komision të jetë.konstatoj se nga 13 antar prezent 13 janë pro,
Tani ju ftoj anëtar të kuvendit që te propozoni dy e me teper kandidat per Kryesues të Kuvendit urdheroni po i pres propozimet .
Negovan Jovanovic unë ptopozoj që si kandidat per kryesues të jetë Milica Jovanovic .
Dobrivoje Djordjevic unë propozoj që kandidat tjeter të jetë Ivica Cenic .
Zv.Keyesuesi pra shkojm me nje pauzë deri sa komisioni dhe sekretaria e kuvendit të pregaditin fletvotimet dhe vendin per te votuar,
Zv.Kryesuesi. më qense komisioni ka pregadit fletvotimet dhe vendin në sall per të votuar ju ftoj që sipas emrit që do të therras të dalë te votoj, po ashtu ju noftoj se fletvotimi është i vlevshem nese votohet vetem një kandidat,nese dy kandidatet që janë në fletvotim votohen të dy atëhere kjo fletvotim është i pa vlevshem.
Zy,Kryesuesi ju njoftoj se 13 anëtar janë prezent në sall dhe 13 kanë marr pjes në votim fjalen ja jap kryetarit të komisionit zt.Stefan Kovacevic urdheroni zt.kovacevic.
Stafan Kovacevic nga 13 anëtar prezent që janë në sall,kanë votuar keshtu: fletvotime kemi pasur 15 ku dy janë të pa shfrydzuara,një është e demtuar dhe kjo nga komisioni është shpallur e pa vlevshme dhe 12 vota janë për Milica Jovanovic pra me 12 vota pro zgjidhet Milica Jovanovic Kryesuese e Kuvendit .

**Vendim**

Me 12 vota pro dhe 1 kunder zgjidhet Milica Jovanovic Kryesuese e Kuvendit Komunal të Novobërdës.

Zv.Kryesuesi unë i uroj zonjes Milica Jovanovic per zgjedhjen e Kryesuses së keti kuvendi dhe e ftoj që te ulet në vendin e vet që i takon dhe nga ky moment ta udhëheq mbledhjen.
Kryesuesja e Kuvendit milica Jovanovic,ju faleminderit per besimin që ma dhatë shpresoj se do të punojm se bashku edhe ma mirë se që kemi punuar deri tani,tani kalojm në piken tjeter të fundit të rendit të dites .

**Pika e gjashtë:** të ndryshme;
Kryesuesja a ka dikush të flas diqka .
Pranvera Kastrati Gashi,ju faleminderit per fjalen dhe të uroj suksese,siq thash edhe në fillim të mbledhjes ne si kuvend kemi formuar një komitet per siguri në bashksi ata mbajnë mbledhjet dhe nuk po i paguajn meditjet që ju takon andaj se di qka po priteni a mos do të ju padisin sikur arsimtaret që me permbarues ti marrin paret.andaj ju bej thirrje që keto pagesa të kryhen me kohë e mos të shkojn permes Permbarusit ju faleminderit,
Kryesuesja a ka edhe dikush të diskutoj fjalen ja jap drejtorit të financave zt.Milosh Denic urdheroni zotri Drejtor.

Drejtori Milosh Denic unë nje materjal ju kamë derguar në imelat e juaja ku ne kemi shpallur një ftes publike per OJQ e komunes kush është i interesuar që ta aplikojn per projektet që janë në thirrje Publike, Andaj nga ju kerkoj që ju ta bieni një vendim për dhenjen e Pajtushmeris kryetarit të komunes që te ketë te drejten per financimin e programeve dhe subvencioneve në bazë të Fteses Publike me nr.02/169.
Ramush Mehmeti ti zt.Drejtor je i pa kjart ne duhet te dim se qka duhet të miremi vendim se sipas rregullores per subvencione Kryetari ka të drejt deri në 5.000 euro të subvencionoj ,ndersa mbi 5.000 duhet ta marr vendim kuvendi .
Drejtori i Financave ndersa sa i perket pytjes së Pranvera Kastrati Gashi,në komunen ton komiteti per siguri në bashksi ka mbajtur mbledhje dhe unë e di se nga koha e me hershme ky komitet është paguar unë kam pytur koleget në graqanic dhe ata me kanë sygjeruar se te ta nuk po pagujke ky komision.
Zv.Kryesuesi ,Drejtor Komiteti per Siguri në Bashksi anëtaret që janë punëtor të komunes nuk ju takon meditja ndersa anetarve tjer që nuk janë puntor te komunes ju takon meditja andaj ligjerisht komunes i takon me i pagu meditjet per komisionin per siguri në bashksi vetem atyre që nuk janë punëtor te tyre.

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesja i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.
E shpall të mbyllur mbledhjen e Dytë të vitit 2025.

**Vrejtje**: procesverbali është nxjerr nga ingjizimi i diktafon, ingjizimi i mbledhjes është i ruajtur dhe mund te keni qasje në qdo kohë në rast të ndonje gabimi gjatë perpilimit ose perkthimit të procesverbalit të nderuar anëtar të asambles Komunale të Novobërdës.

**Sylejman Avdyli**
Procesmbajtëse

**Milica Jovanovic**
Kryesuese e Kuvendit